



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

SFIDAT DHE PRAKTIKAT E GJITHËPËRFSHIRJES NË SEKTORIN E SIGURISË NË KOSOVË



Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autorë: Shpat Balaj and Plator Avdiu

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze

Prishtinë
Mars 2020

Canada

Ky projekt është financuar nga Fondi i Kanadasë për Iniciativat Lokale (CFLI) - një iniciativë e Qeverisë së Kanadasë

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo mjet tjetër, pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Ky botim u prodhua me mbështetjen e Fondit të Kanadasë për Iniciativat Lokale (CFLI). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Qeverisë së Kanadasë. Aktivitetet e projektit u zhvilluan nën asistencën e Humani Centar Mitrovica.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

SFIDAT DHE PRAKTIKAT
E GJITHËPËRFSHIRJES NË
SEKTORIN E SIGURISË NË
KOSOVË

PËRMBAJTJA

GJETJET KYÇE	5
HYRJE	7
KORNIZA LIGJORE E FSK-SË PËR GJITHËPËRFSHIRJEN ETNIKE	9
VËSHTRIM I PRAKTIKAVE TË GJITHËPËRFSHIRJES NË FSK.....	11
Gjendja aktuale e gjithëpërfshirjes në FSK.....	12
Mekanizmat e brendshëm ekzistues të gjithëpërfshirjes në FSK.....	14
Komunikimi si masë e gjithëpërfshirjes.....	15
Masat e tjera specifike.....	16
Ndërhyrja e jashtme	17
Zgjerimi i bashkëveprimit mes FSK-së dhe komuniteteve hezituese.....	19
Zvogëlimi i hendekut gjinor	20
KORNIZA LIGJORE E PK-SË PËR GJITHËPËRFSHIRJEN ETNIKE	22
GJENDJA AKTUALE E GJITHËPËRFSHIRJES ETNIKE NË POLICINË E KOSOVËS	23
SFIDAT E INTEGRITETIT DHE QEVERISJES SË MIRË TEK ZYRTARËT POLICORË SERBË TË KOSOVËS.....	29
Rasti i stacionit policor të Zubin Potokut	30
Aksioni policor në veri.....	31
Kritika ndaj performancës së drejtorisë rajonale të policisë në Mitrovicë-Veri.....	32
REKOMANDIME	33

GJETJET KYÇE

- Sfidat që ka FSK-ja në përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë janë të lidhura kryesisht me zhvillimet politike e që janë jashtë kompetencave të saja. Andaj, adresimi i tyre kërkon bashkëpunim të gjerë ndërinstytucional.
- Mekanizmat që sigurojnë përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në FSK janë në një nivel të kënaqshëm. Sidoqoftë, pas dorëheqjeve të pjesëtarëve serbë në dy vitet e fundit për shkak të presionit të Serbisë, ka pasur një regres të konsiderueshëm në përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në FSK.
- FSK-ja vazhdon ta kultivojë parimin e multi-etnicitetit pas transformimit të misionit të vet. Për më tepër, pas transformimit, FSK-ja i ka rritur përpjekjet e veta për zhvillimin e procesit të gjithëpërfshirjes duke përshtatur dokumente të ndryshme specifike për përfaqësimin gjinor dhe etnik.
- Përfaqësimi gjinor i komuniteteve jo-shumicë në FSK është në nivel shumë të dobët. Vetëm 23 gra nga komunitetet jo-shumicë janë të angazhuara në FSK.
- Marrë parasysh që çështjet e promovimit të të gjitha komuniteteve jo-shumicë janë të rëndësishme edhe për promovimin e FSK-së dhe nxitjen e gjithëpërfshirjes, mungesa e prezencës së FSK-së në të gjitha rajonet e Kosovës e pengon këtë proces.
- Nga gjithsej 8,861 të punësuar në Policinë e Kosovës, përfshirë stafin civil dhe zyrtarët policorë, 1,406 prej tyre përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë të Kosovës. Kjo nënkupton që rreth 16 përqind e stafit civil dhe zyrtarëve policorë të PK-së përbëhet nga pjesëtarë që u përkasin komuniteteve jo-shumicë.
- Rreth 12 përqind e stafit të policisë i takojnë komunitetit serb në Kosovë. Prandaj, mund të thuhet se komuniteti serb në Kosovë është i përfaqësuar mirë në institucionet e sigurisë, me theks të veçantë në Policinë e Kosovës. 4 përqindjet e tjera ndahen mes komuniteteve të tjera jo-shumicë (komunitetet e boshnjakëve, turqve, gornëve, ashkalinjve, romëve, egjiptasve, çerkezëve, malazezëve, kroatëve dhe maqedonasve, siç tregohet nga statistikat e siguruara nga PK-ja). Ndërkohë, shqiptarët e Kosovës, si popullsia shumicë e vendit, përbëjnë 84 përqind të personelit në PK.

- Policia e Kosovës ka 1,011 të punësuar në stafit civil dhe 7,850 zyrtarë policorë të shpërndarë në grada dhe pozita të ndryshme në kuadër të institucionit. Prej tyre, 109 të punësuar të stafit civil janë nga komunitetet jo-shumicë dhe 1,297 të tjerë janë zyrtarë policorë që përfaqësojnë komunitete të ndryshme jo-shumicë. Rrjedhimisht, 8 përqind e stafit civil përfaqëson komunitetin serb të Kosovës, ndërkohë që zyrtarët policorë që i përkasin komunitetit serb të Kosovës janë 12 përqind.
- Komuniteti serb i Kosovës duket se është i vendosur mirë në kuadër të sistemit të gradimit të policisë. Në kuadër të personelit të zyrtarëve policorë, serbët e Kosovës janë të përfaqësuar me 2 kolonelë, 4 nënkolonelë, 7 majorë, 14 kapitenë, 26 policë të rinj, 28 togerë, 52 rreshterë, ndërkohë që 821, ose shumica e tyre, mbajnë gradën e policit dhe shërbejnë në drejtori të ndryshme rajonale të PK-së.
- Sa i përket përfaqësimit gjinor të komunitetit serb të Kosovës, në PK janë inkuadruar 148 femra dhe 889 meshkuj nga ky komunitet. Këto shifra për të dy gjinitë përfshijnë si stafin civil ashtu edhe zyrtarët policorë.
- Sidoqoftë, dëshmitë tregojnë se drejtorja rajonale e policisë në Mitrovicën e Veriut është sfiduar rëndë kur flitet për integritetin e policëve të saj dhe qeverisjen e mirë në përgjithësi. Ka disa raste që demonstrojnë ekzistencën e akuzave serioze se zyrtarët policorë në veriun e Kosovës dyshohen se kanë qenë të përfshirë në veprimtari të paligjshme dhe sjellje të pahijshme.

HYRJE

Që në fazat e hershme, zhvillimi i sektorit të sigurisë, veçanërisht i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policisë së Kosovës (PK), është bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes. Sot, PK-ja përbëhet në radhët e veta ka rreth 16 përqind të komuniteteve jo-shumicë, ndërkohë që FSK-ja deri në 8 përqind sosh. Nga ana tjetër, gratë në PK përbëjnë 15 përqind të numrit të përgjithshëm, kurse në FSK gratë përbëjnë rreth 8 përqind të pjesëtarëve aktive. Ndërkohë, niveli i përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në PK dhe FSK është i kënaqshëm dhe pasqyron përbërjen etnike të Kosovës, përfaqësimi në grada më të larta dhe pozita udhëheqëse, si dhe përfaqësimi i grave nga komunitetet jo-shumicë, lë për të dëshiruar. Përkundër përparimit në përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë, qëndrueshmëria e gjithëpërfshirjes së komuniteteve jo-shumicë, përkatësisht e komunitetit serb të Kosovës, sfidohet vazhdimisht nga konotacioni politik që i është dhënë dhe për pasojë i lë në hije zhvillimet e sfidat aktuale të praktikave të gjithëpërfshirjes në PK dhe FSK.

Ky raport ofron një pasqyrë të nivelit aktual të gjithëpërfshirjes së komuniteteve jo-shumicë në PK dhe FSK. Si i tillë, ai analizon gjendjen e gjithëpërfshirjes në këto institucione dhe masat e marra për të siguruar qëndrueshmëri në proces. Për më tepër, vëmendje e veçantë i është kushtuar procesit të rekrutimit, praktikave në këtë drejtim dhe masave specifike të marra për t'i afruar komunitetet më shumë me këto institucione. Më tej, punimi ofron një pasqyrë të funksionimit të mekanizmave ekzistues të brendshëm që mbikëqyrin dhe kontribuojnë në zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse. Ndër të tjera, punimi fokusohet në integritetin e pjesëtarëve nga komunitetet jo-shumicë, veçanërisht në PK dhe sfidat e paraqitura për sigurimin e integritetit.

Raporti pasqyron hulumtimin e gjerë të realizuar nga ekipi i QKSS-së në komunat kyçe me shumicë serbe në vitet e fundit, si dhe punën në terren në komunat ku banojnë komunitete të tjera jo-shumicë. Për qëllimet e këtij raporti, u organizuan dy diskutime publike në Graçanicë dhe Shtërpcë, si dhe u zhvilluan një serë intervistash sy më sy me shoqërinë civile, institucionet lokale dhe përfaqësuesit e qeverisë. Për më tepër, të dhënat parësore të raportit janë marrë zyrtarisht nga PK-ja dhe FSK-ja, ndërkohë që ekipi hulumtues ka realizuar një analizë të hollësishme të përmbajtjes së dokumenteve zyrtare, raporteve dhe kornizës ligjore përkatëse. Të dhënat e raportit mbështeten edhe në programet ekzistuese të QKSS-së për integritetin dhe gjithëpërfshirjen në institucionet e sigurisë, konsultimet dhe takimet e vazhdueshme me ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve, si dhe në përfshirjen e ekipit të QKSS-së në proceset përkatëse në sektorin e sigurisë në Kosovë dhe rajon.

KORNIZA LIGJORE E FSK-SË PËR GJITHËPËRFSHIRJEN ETNIKE

Baza për përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) buron nga **Kushtetuta e Republikës së Kosovës** dhe **Ligji i ri për Forcën e Sigurisë së Kosovës**, i cili hyri në fuqi më 4 janar 2019. Të dy këto dokumente pohojnë se FSK-ja “*pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës*”.¹ **Ligji për FSK-në** shprehet në mënyrë të qartë që një nga parimet themelore të FSK-së është karakteri i saj gjithëpërfshirës dhe shumetnik.² Për më tepër, shërbimi në FSK udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit; dhe siç përcaktohet me **Ligjin për Shërbimin në FSK**, çdo “*pjesëtar i FSK-së gëzon trajtim të drejtë dhe të barabartë, çmohet dhe respektohet si individ, mbështetet dhe shpërblehet sipas rregullave dhe kushteve të shërbimit*”.³ Për më tepër, **Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes (MM)**, i cili shfuqizoi ligjin e mëparshëm për Ministrinë e FSK-së, e formon Ministrinë e Mbrojtjes si organ të administratës shtetërore, të përbërë nga nëpunës civilë dhe ushtarakët e FSK-së. Kështu, nëpunësit civilë të punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes, përveç të emëruarve politikë, u nënshtrohen ligjeve që rregullojnë shërbimin civil të Republikës së Kosovës.⁴ Si i tillë, **Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës** garanton trajtimin e drejtë dhe të barabartë të të gjithë nëpunësve civilë, pavarësisht përkatësisë etnike, dhe pohon se shërbimi civil i Kosovës duhet të pasqyrojë multi-etnicitetin dhe barazinë gjinore.⁵

Përveç kornizës ligjore që ofron një bazë të qëndrueshme për të siguruar përfshirje të vazhdueshme të komuniteteve jo-shumicë, Ministria e Mbrojtjes ka miratuar edhe “**Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Jo-shumicë (2019-2023) në MM/FSK**” dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj.⁶ Përmes kësaj strategjie, Ministria e Mbrojtjes synon të sigurojë një integrim të qëndrueshëm të komuniteteve jo-shumicë, të sigurojë mundësi më të mëdha për rritje

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 126 [Forca e Sigurisë së Kosovës].

2 Ligji Nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 5 [Parimet e FSK-së].

3 Ligji Nr. 06/L-124 për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 25 [Të drejtat e pjesëtarit të Forcës së Sigurisë së Kosovës].

4 Ligji Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, neni 4 [Ministria e Mbrojtjes].

5 Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, nenet 3 dhe 43.

6 Raporti Vjetor 2019 i MM-së/FSK-së.

në grada dhe pozita, të rrisë vizibilitetin dhe aktivitetet e FSK-së për komunitetet jo-shumicë, si dhe të ofrojë një vizion afatgjatë për integrim të vazhdueshëm në Ministrinë e Mbrojtjes/FSK-në. Strategjia rrjedh nga përkushtimi strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e të gjitha komuniteteve në institucionet e Republikës së Kosovës, dhe është dizajnuar duke u bazuar në objektivat strategjike të MM-së.⁷ Për më tepër, në vitin 2017, MM-ja⁸ miratoi edhe *“Planin e rekrutimit për pjesën aktive vetëm për komunitetet jo-shumicë”*, i cili mundësoi një proces të lehtësuar rekrutimi për komunitetet jo-shumicë, duke siguruar ekipe mobile të rekrutimit në komunat me popullsi jo shumicë për të pranuar dhe inkurajuar aplikimet në FSK.⁹

Krahas sigurimit të multi-etnicitetit, baza ligjore e Kosovës garanton dhe promovon edhe barazinë gjinore si vlerë thelbësore e zhvillimit shoqëror. Ndërkohë që Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbetet shtylla kryesore mbrojtëse e barazisë gjinore, **Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës**, ofrojnë masa specifike për të siguruar se diskriminimi i bazuar në gjini dhe nën-përfaqësimi të mos jenë të pranishëm në institucionet publike. Këto dispozita janë mishëruar në masë të konsiderueshme edhe në **Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligjin për Shërbimin në FSK dhe Ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes (MM)**, të cilët garantojnë trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë pjesëtarët e MM-së dhe FSK-së.

7 Po aty.

8 Në kohën kur u miratua ky plan, Ministria e Mbrojtjes njihej zyrtarisht si Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

9 Balaj, S. dhe Boshnjaku, T. (2018). *Tendenat e shkatërrimit të multi-etnicitetit - Dorëheqjet masive të anëtarëve serbë nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe roli i Serbisë*. QKSS.

VËSHTRIM I PRAKTIKAVE TË GJITHËPËRFSHIRJES NË FSK

Tranzicioni gradual i sektorit të mbrojtjes së Kosovës është karakterizuar nga bashkëpunimi i ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare, si dhe nga standardizimi i kujdesshëm me standardet dhe praktikën e NATO-s. Në këtë mënyrë, që nga themelimi i FSK-së në vitin 2009, përveç bazës ligjore, nën mbikëqyrje të vazhdueshme nga të gjithë palët vendore dhe ndërkombëtare ka qenë edhe përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në FSK. Pavarësisht sfidave, përpjekjet e vazhdueshme për zhvillimin e karakterit shumetnik të FSK-së kanë marrë mbështetje nga partnerët e saj, si dhe kanë krijuar një bazë solide për avancimin e mëtejshëm të misionit të saj. Më 14 dhjetor 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi ligje të reja¹⁰ për rregullimin e funksionimit dhe mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilët mundësuan tranzicionin e FSK-së nga “... një instrument i sigurisë, për të mbështetur Qeverinë e Republikës së Kosovës”¹¹ në “... një forcë ushtarake shumetnike, profesionale, të armatosur dhe të autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë tij...”¹² Prej NATO-s, tranzicioni i FSK-së u perceptua se po bëhej në kohën e gabuar¹³. Për më tepër, disa vende anëtare të NATO-s besonin se tranzicioni do të duhej të ishte bërë me ndryshime kushtetuese e jo me ndryshime ligjore. Kjo kritikë u përdor nga eksponentë të caktuar si momentum për ta përshkruar tranzicionin si “të rrezikshëm” dhe vazhdimin e një fushate shkatërruese që minon karakterin shumetnik të FSK-së.¹⁴ Teza e kësaj fushate ishte kërcënimi që mund të paraqiste tranzicioni i FSK-së ndaj komuniteteve jo-shumicë, përkatësisht ndaj komunitetit serb të Kosovës dhe pozicionit të tyre në kuadër të FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes.¹⁵

10 Ligjet që hynë në fuqi pas miratimit në Kuvend janë: 1) Ligji Nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës; 2) Ligji Nr. 06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës; 3) Ligji Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes.

11 Ligji i shfuqizuar Nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 5 [Misioni dhe detyrat].

12 Ligji Nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 5 [Kompetencat dhe detyrat].

13 NATO. (2018). *Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për miratimin e ligjeve për tranzicionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës*. Në dispozicion në: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_161631.htm

14 Balaj, S. dhe Boshnjaku, T. (2018). *Tendencat e rrënimt të multi-etnicitetit - Dorëheqjet masive të anëtarëve serbë nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe roli i Serbisë*. QKSS.

15 Insajderi. *Serbët po mundohen ta ndalojnë transformimin e FSK-së në ushtri*. Në dispozicion në: <https://insajderi.com/serbet-po-mundohen-ta-ndalojne-transformimin-e-fsk-se-ne-ushtri/>

Sidoqoftë, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës ishin shumë të zëshëm për të theksuar se gjithëpërfshirja e komuniteteve jo-shumicë do të vazhdojë të jetë një vlerë thelbësore edhe pas tranzicionit të mandatit të FSK-së, dhe përmes garancive ligjore, qëllimi i saj i vetëm do të jetë mbrojtja e interesave të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, pavarësisht përkatësisë etnike.¹⁶ Gjithashtu, Ministria e Mbrojtjes ka ofruar trajnime për të gjitha njësitë e FSK-së në lidhje me kornizën ligjore, me fokus në përgjegjësitë e pjesëtarëve të FSK-së gjatë angazhimit të tyre në FSK, të drejtat e njeriut dhe aspektin gjinor.¹⁷ Më tej, në vitin 2019 është bërë një studim i brendshëm nga FSK-ja me pjesëtarët nga të gjitha komunitetet jo-shumicë në lidhje me tranzicionin e misionit të saj. Për më tepër, kjo anketë ka analizuar edhe trajtimin e komuniteteve jo-shumicë ndërkohë që janë në detyrë, diskriminimin, presionin e jashtëm me të cilin përballen për shkak të angazhimit të tyre në FSK, dhe rrugën drejt integritit të vazhdueshëm e të qëndrueshëm dhe zhvillimit të karrierës.¹⁸ Shumica e të anketuarve kanë shprehur perceptim pozitiv për tranzicionin e misionit të FSK-së¹⁹, por duke qenë se këto rezultate nuk janë të qasshme për publikun, nuk dihet perceptimi për çështje të tjera të adresuara nga kjo anketë e bërë.

GJENDJA AKTUALE E GJITHËPËRFSHIRJES NË FSK

Aktualisht, komunitetet jo-shumicë përfaqësojnë tetë për qind të numrit të përgjithshëm të pjesëtarëve të FSK-së. Prej 217 pjesëtarëve nga komunitetet jo-shumicë, 49 prej tyre vijnë nga komuniteti serb në Kosovë; derisa dy komunitetet më të përfaqësuara në FSK janë komuniteti boshnjak me 64 pjesëtarë dhe komuniteti turk me 55 pjesëtarë.²⁰ Statistikat e detajuara për përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në kuadër të FSK-së paraqiten në figurën e mëposhtme. Komunitetet jo-shumicë janë të përfaqësuara mirë në kategorinë e nënoficerëve dhe oficerëve me grada të ulëta, ndërkohë që lë për të dëshiruar përfaqësimi në radhët e oficerëve me grada të nivelit të mesëm dhe të lartë. Nën-përfaqësimi në radhët e oficerëve është më i dukshëm kur flitet për komunitetin serb të Kosovës, me vetëm tre pjesëtarë që

16 Presidenti i Republikës së Kosovës Thaçi, H. (2017). Në konferencën “Qëndrimet e komunitetit serb për tranzicionin e mandatit të FSK-së”. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Qendra Kërkimore për Politikën e Sigurisë, Prishtinë, Kosovë.

17 Raporti Vjetor 2018 i FSK-së.

18 Raporti Vjetor 2019 i FSK-së.

19 Po aty.

20 Raporti Vjetor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, 2019.

mbajnë gradat më të ulëta për oficer, përkatësisht nëntoger dhe toger.²¹ Për pasojë, pozita më e lartë drejtuese që mund të mbajnë pjesëtarët serbë të FSK-së bazuar në gradat e tyre, është komandant i togës.²² Deri në vitin 2023, FSK-ja synon të avancojë përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në të gjitha nivelet. Në këtë drejtim, objektivat kryesore të strategjisë për integrimin e komuniteteve jo-shumicë janë rritja e përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në 10 për qind; rritja e përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në të gjitha gradat, si dhe rritja e vizibilitetit të aktiviteteve të FSK-së ndaj komuniteteve jo-shumicë.

Tabela 1 Struktura e pjesëtarëve të FSK-së nga komunitetet jo-shumicë, sipas përkatësisë etnike.

Përkatësia etnike	Numri
Serb	49
Boshnjak	64
Turk	55
Goran	2
Ashkali	31
Rom	3
Egjiptas	10
Malazez	2
Gjerman	1
Gjithsej	217

21 Po aty

22 Rregullorja Nr. 03/2018 për zhvillimin e karrierës së pjesëtarëve të FSK-së.

MEKANIZMAT E BRENDSHËM EKZISTUES TË GJITHËPËRFSHIRJES NË FSK

Sekretari i Përgjithshëm i MM, përmes vartësve të tij, Njesisë për të Drejtat e Njeriut (NjDNj) dhe Zyrës së Çështjeve të Komunitetit (ZÇK), është organi kryesor që siguron përdorimin praktik të dispozitave ligjore që përqendrohen në përfaqësimin etnik dhe gjinor²³. Këto dy mekanizma u krijuan për të promovuar llogaridhënien e brendshme, kryesisht në çështjet e gjithëpërfshirjes, duke siguruar standardizimin e politikave të brendshme me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe legjislacionin kombëtar, si dhe për të nxitur bashkëpunimin me mekanizma, institucione dhe organizata joqeveritare të tjera relevante. Për më tepër, funksionimi i tyre kontribuon në politikë-bërjen e brendshme duke shërbyer si organe këshilluese dhe monitoruese në hartimin e politikave. Si të tillë, ata sigurohen që hartimi i politikave në MM dhe FSK të marrë parasysh legjislacionin përkatës ndërkombëtar dhe vendor në lidhje me të drejtat e komuniteteve jo-shumicë.²⁴

NjDNj dhe ZÇK janë të përfshira edhe në procesin e rekrutimit. Fushata e re e rekrutimit u monitorua nga këto mekanizma nga faza e hershme e informimit deri në fazën e përzgjedhjes. Ata kanë përpiluar një raport për perspektivën e gjithëpërfshirjes së procesit, përmes të cilit ofruan gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.²⁵ Për më tepër, gjatë vitit 2019, ata kryen vizita informuese/monitoruese në akademitë partnere të FSK-së që ku kryesisht vazhdojnë shkollimin pjesëtarë të FSK-së nga komunitetet jo-shumicë.²⁶ Për të avancuar një proces të paanshëm të rekrutimit, Ministria e Mbrojtjes ka paraparë regjistrimin e digjitalizuar të të gjitha intervistave në procesin e rekrutimit, si dhe një procedurë më të detajuar raportimi për komisionin e vlerësimit të intervistave.²⁷ Ndërkohë që nuk ka ndonjë dispozitë ligjore që parashikon përfaqësimin etnik dhe gjinor në bordin e përzgjedhjes së procesit të rekrutimit, krijimi i komisionit të vlerësimit të intervistave duhet të marrë parasysh përfaqësimin etnik dhe gjinor.²⁸ Për më tepër, përfaqësimi etnik dhe gjinor është paraparë në bordet për emërimet

23 Udhëzim Administrativ Nr. 08/2019 për Misionin, Organizimin dhe Strukturën e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjetendet në: <https://mod.rks-gov.net/repository/docs/Admin%20Instruction%20on%20the%20MKSF.pdf>

24 Po aty.

25 Raporti Vjetor 2019 i FSK-së.

26 Po aty.

27 Plani i Integritetit i MM-së/FSK-së 2019-2022.

28 Draft rregullorja (MM) Nr. XX/2019 për rekrutimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

dhe ngritje në detyrë.²⁹ Sidoqoftë, meqenëse rregulloret e brendshme kanë paraparë kriteret e gradimit dhe pozitive të anëtarëve të këtyre bordeve, përfaqësimi etnik nuk është i garantuar në mungesë të gradave dhe pozicioneve përkatëse.

KOMUNIKIMI SI MASË E GJITHËPËRFSHIRJES

Njohja e gjuhës shqipe ose serbe nuk është kriter pranimi në FSK. Pjesëtarëve të FSK-së u ofrohen kurse të të dy gjuhëve; megjithatë, kurset e tilla nuk kanë karakter detyrues.³⁰ Ndërkohë që mund të argumentohet se në sektorin e mbrojtjes mungesa e njohurisë së gjuhës parësore të institucionit mund të rezultojë në pengesa operative, në këtë rast ky u përdor si mjet strategjik për afrimin e komunitetit serb me FSK-në. Sidoqoftë, FSK-ja duhet t'i përdorë njohuritë e të dy gjuhëve zyrtare si stimul për pjesëtarët e saj dhe rekrutët e rinj. Kjo mund të bëhet duke e promovuar dygjuhësinë si përparësi në marrjen e gradave të caktuara më të ulëta dhe pikëve shtesë në procesin e rekrutimit; ndërkohë, përveç anglishtes, njohuritë e dy gjuhëve zyrtare duhet të jenë të detyrueshme për të marrë grada më të larta e pozita të larta. Duke vepruar kështu, përveç përmirësimeve në performancën operative, do të promovohen mekanizmat e brendshëm të trajnimit dhe edukimit, do të paraqiten grupe shkathtësish më të mira të rekrutëve, do të forcohet parimi i meritokracisë dhe kurset e gjuhës mund të avancohen në një shkollë gjuhësore ushtarake të konsoliduar mirë. Rrjedhimisht, kjo do të mund ta hapte rrugën për përfshirje më të madhe të komunitetit serb të Kosovës në edukimin ushtarak, si dhe do të forconte ndjenjën e përkatësisë në FSK. Përveç komunikimit të brendshëm, një pjesë e rëndësishme e gjithëpërfshirjes është shtrirja në komunitete të ndryshme përmes komunikimit. Në vitin 2019, FSK-ja kishte më shumë se 500 prezantime të lidhura me komunikimin/mediat, ku përfshihen njoftimet për shtyp, paraqitjet mediatike, fushatat mediatike, etj. Përveç kësaj, u prodhuan katër reklama/fushata në TV/Radio në gjuhën shqipe dhe serbe, ndërkohë që njoftimet për shtyp janë përkthyer edhe në serbisht.³¹ Sidoqoftë, përkundër interesit të ekipit hulumtues për të marrë më shumë informacione në këtë drejtim, FSK-ja nuk ka qartësuar nëse të gjitha materialet për media janë përkthyer në serbisht. Nga ana tjetër, buletini i rregullt i FSK-së i botuar nga Ministria e Mbrojtjes është në dispozicion vetëm në gjuhën angleze. Korniza ligjore është e qasshme në shqip, serbisht dhe

29 Rregullorja Nr. 03/2018 për zhvillimin e karrierës së pjesëtarëve të FSK-së.

30 Emini, D. (2014). Përfshirje apo përjashtim - pakicat në sektorin e sigurisë në Kosovën e pavarur. QKSS.

31 Raporti Vjetor 2019 i FSK-së,

anglisht përmes faqes zyrtare të MM-së. Ndërsa, sektori i dokumenteve strategjike në ueb faqen zyrtare nuk ka publikime në gjuhën serbe. Në mënyrë të ngjashme, raporti i fundit vjetor i cili është në dispozicion në serbisht dhe anglisht është i vitit 2017, ndërkohë që raportet e fundit vjetore për vitet 2018 dhe 2019 janë në dispozicion vetëm në shqip.

MASAT E TJERA SPECIFIKE

Meqenëse korniza e përgjithshme ligjore parashikon që përveç kornizës ligjore ekzistuese, të gjitha institucionet publike marrin masa të përgjithshme dhe të veçanta për të arritur barazinë gjinore³², Ministria e Mbrojtjes ka miratuar **“Politikën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në MM dhe FSK”**. Ky dokument i shërben Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së si një udhëzues efektiv dhe i qëndrueshëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, barazinë gjinore dhe gjithëpërfshirjen e komuniteteve jo-shumicë.³³ Ky dokument synon të arrijë objektivin e ngritjes së nivelit të përfaqësimit gjinor dhe etnik në MM dhe FSK përmes aktiviteteve specifike. Këto aktivitete përfshijnë organizimin e fushatave specifike informuese që synojnë komunitetet jo-shumicë dhe gratë si një masë inkurajuese, si dhe organizimin e punëtorive për promovimin e karakterit shumetnik të FSK-së. Meqenëse në opinionin e përgjithshëm në Kosovë mungon vetëdija për rëndësinë e gjithëpërfshirjes, veçanërisht për përfaqësimin gjinor, FSK-ja synon ta trajtojë këtë çështje në nivelin e komunitetit duke prodhuar dokumentarë dhe materiale të shkruara për rritjen e vetëdijes.³⁴ FSK-ja ndërmerr edhe aktivitete të ndryshme që synojnë komunitetet jo-shumicë për të zgjeruar prezencën e tyre tek komunitetet përkatëse. Në lidhje me këtë, prej vitit 2010, FSK-ja ofron ekzaminime mjekësore në baza mujore dhe ndihmë në komunat me shumicë serbe në rajonin e Istogut. FSK-ja ka siguruar mbështetje logjistike në projekte të ndryshme infrastrukturore në komuna të ndryshme dhe zona të vogla rurale, kryesisht në komunat e populluara nga komunitetet jo-shumicë.³⁵

32 Ligji Nr. 05/L -020 për barazinë gjinore, nenet 5 dhe 6.

33 Politika e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK.

34 Po aty.

35 Raporti Vjetor 2018 i FSK-së.

SFIDAT E GJITHËPËRFSHIRJES SË KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË FSK

Gjithëpërfshirja e komuniteteve jo-shumicë ka qenë fjalëkalimi i të gjitha proceseve që përcaktuan krijimin e institucioneve të Kosovës. Përderisa multi-etniciteti ishte një nga parimet themeluese të institucioneve vendore, pozicioni i komunitetit serb në Kosovë u përdor nga aktet kundërshtarë për ta sfiduar pronësinë lokale, veçanërisht në sektorin e sigurisë. Aplikimi i një qasjeje të tillë jo-konstruktive në kundërshtimin e shtetësisë së Kosovës, shfrytëzimi i një komuniteti të caktuar për këtë dhe trajtimi i gjithëpërfshirjes së komuniteteve lokale jo-shumicë në procese politike bilaterale, e kanë dëmtuar procesin e gjithëpërfshirjes në një farë mase. Si pasojë e kësaj, janë lënë në hije kritikët konstruktive ndaj procesit të gjithëpërfshirjes në sektorin e sigurisë dhe analizat e mirëfillta në këtë drejtim duke i'u veshur procesit një natyrë politike. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme dhe hedhjes së themeleve të gjithëpërfshirjes në një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse, efektiviteti i administrimit të gjithëpërfshirjes në FSK u dobësua nga narracioni politik që e ka rrethuar.

NDËRHRYJA E JASHTME

Në 2 vitet e fundit, Serbia ka ndërmarrë një fushatë të ashpër për të dëmtuar përfshirjen e komunitetit serb të Kosovës në institucionet e Kosovës, e cila rrjedhimisht çoi në regres në procesin e gjithëpërfshirjes edhe në kuadër të FSK-së. Në rastin e FSK-së, kjo fushatë ka marrë përmasa të dhunshme. Gjatë vitit 2018, pati një seri sulmesh të orkestruara kundër pronave të pjesëtarëve serbë të FSK-së, kryesisht në rajonin e Mitrovicë-Veri.³⁶ Për më tepër, shumë prej pjesëtarëve serbë të FSK-së u ndaluan në kufi me Serbinë kur udhëtuan për vizita familjare, ndërkohë që disa prej tyre iu ndaluan edhe hyrja në Serbi.³⁷ Për të shtuar presion të mëtejshëm përderisa këto sulme ishin në vazhdim e sipër, udhëheqësit e Serbisë i bënë thirrje komu-

36 Shehu, B. (2018). *Kosovë: Dënohen sulmet ndaj pjesëtarëve serbë të FSK-së*. DW. Në dispozicion në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-d%C3%ABnohen-sulmet-ndaj-pjes%C3%ABtar%C3%ABve-serb%C3%AB-t%C3%AB-fsk-s%C3%AB/a-44108891>

37 Koha NET (2018). *FSK-ja fton serbët t'i bashkohen në procesin e transformimit*. Koha.NET. Në dispozicion në: <https://www.koha.net/arberi/120996/fsk-ja-fton-serbet-ti-bashkohen-ne-procesin-e-transformimit/>

nitetit serb në Kosovë që të mos t'i bashkëngjiten FSK-së.³⁸ Një qasje e ngjashme u përsërit edhe nga përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kuvendin e Kosovës. Në vend që të dënonin sulmet, ata e kundërshtuan fuqishëm arrestimin e të dyshuarve për sulme ndaj pjesëtarëve serbë dhe iu bashkuan narrativës destruktive se komuniteti serb në Kosovë nuk duhet të përfshihet në FSK.³⁹ Kështu që, një numër i madh i pjesëtarëve serbë të FSK-së u detyruan të jepnin dorëheqjen nga detyrat e tyre, duke e ulur dukshëm përfaqësimin e këtij komuniteti në kuadër të FSK-së.

FSK-ja është treguar shumë efektive në zbatimin e strategjisë paraprake për integrimin e komuniteteve jo-shumicë (2017 - 2020), duke përmbytur objektivin kryesor të ngritjes në mbi 10 për qind të përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë. Sidoqoftë, dorëheqjet e detyruara bën që FSK-ja të bëjë një hap prapa dhe parandaluan një rritje të mundshme në përqindjen e dëshiruar të përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë. Përveç dëmeve që i janë bërë FSK-së në procesin e gjithëpërfshirjes, ndërhyrja e Serbisë dhe vartësve të saj në Kosovë ka pasur ndikim negativ edhe në fusha të tjera. Në fillim të këtij viti, një qytetar serb i Kosovës është përzgjedhur dhe është pajtuar t'i bashkohet Përfaqësueses së Kosovës në Futboll. Rrjedhimisht, prindërit e tij u kërcënuan dhe u sanksionuan me përjashtim nga puna në komunën me shumicë serbe të Graçanicës.⁴⁰ Kjo dëshmon se problemet me gjithëpërfshirjen në FSK nuk burojnë nga vetë FSK-ja dhe sfidat nuk mund të zgjidhen vetëm me përpjekjet e FSK-së. Pas transformimit të misionit të saj, FSK-ja ka thelluar bashkëpunimin me institucionet e tjera për të adresuar sfidat e përfshirjes sipas një këndvështrimi gjithëpërfshirës. Përfaqësuesit e MM-së kanë pasur takime me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim për të paraqitur qëndrimin e pjesëtarëve të FSK-së nga komunitetet jo-shumicë ndaj procesit të tranzicionit dhe rrugën e ardhshme për përfshirje të vazhdueshme.⁴¹ Sidoqoftë, duke pasur parasysh që sulmet e drejtpërdrejta ndaj pjesëtarëve të FSK-së kanë natyrë të sigurisë, nuk ka informata nëse çështje të tilla janë diskutuar në institucionet e sigurisë apo nëse ekziston një plan i përbashkët për ta adresuar këtë problem. FSK-ja, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera të sigurisë, duhet të hartojë një plan të qartë si të parandalo-

38 Kallxo.com. (2018). *Beogradi nuk dëshiron të shohë pjesëtarë serbë në FSK*. Gjendet në: <https://kallxo.com/shkurt/beogradi-nuk-deshiron-te-shohe-pjesetare-serbe-ne-fsk/>

39 Shehu, B. (2018). *Arrestohen e lirohen pesë serbë të Kosovës*. DW. Gjendet në: <https://www.dw.com/sq/arrestohen-e-lirohen-pes%C3%AB-serb%C3%AB-t%C3%AB-kosov%C3%ABs/a-44603540>

40 Klan Kosova. (2020). *Përfshihen nga puna prindërit e futbollistit Iviq, reagon MKRS*. Gjendet në: <https://klankosova.tv/perjashtohen-nga-puna-prinderit-e-futbollistit-iviq-reagon-mkrs/>

41 Raporti Vjetor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, 2019.

hen ndikimet e jashtme dhe të garantohet siguri për të gjithë pjesëtarët e saj të prekur nga sulmet e drejtpërdrejta për shkak të angazhimit të tyre në FSK. Ekipi i hulumtimit ka bërë disa përpjekje për të marrë informata nëse ndërhyrja e jashtme është përfshirë në strategjinë e sigurisë, strategjinë e MM-së/FSK-së ose nëse është zhvilluar një plan specifik për adresimin e saj, megjithatë zyrtarët e FSK-së nuk u janë përgjigjur kërkesave tona në këtë drejtim.

ZGJERIMI I BASHKËVEPRIMIT MES FSK-SË DHE KOMUNITETEVE HEZITUESE

Ndërkohë që FSK-ja synon të rrisë prezencën në komunat e banuara nga komunitetet jo-shumicë, mungesa e pranisë së saj në Mitrovicë-Veri paraqet një pengesë për efikasitetin e arritjes së këtij objekti. Edhe pse që nga themelimi i FSK-së ka pasur një marrëveshje të heshtur se prania e saj në veriun e vendit do të kishte pasoja serioze politike, duket se në vitin 2013 kryeministri i atëhershëm i Kosovës, z. Hashim Thaçi, u zotua përmes një marrëveshje me shkrim se FSK-ja nuk do të shtrihet në veriun e vendit pa miratimin paraprak të KFOR-it, përkatësisht NATO-s.⁴² Presidentja e Kosovës në atë kohë, njëkohësisht ish-Komandante Supreme e FSK-së, nuk ishte në dijeni të një marrëveshje të tillë, edhe pse pati disa takime me KFOR-in dhe përfaqësuesit e kryeministrit pas lidhjes së marrëveshjes përkatëse.⁴³ Pra, niveli politik ndikoi edhe një herë funksionimin e FSK-së në aspektin e gjithëpërfshirjes, pavarësisht se korniza ligjore, mandati dhe objektivat e qarta për shtrirje më të gjerë gjeografike konsiderohen si një masë thelbësore për gjithëpërfshirjen e komuniteteve jo-shumicë, përkatësisht të komunitetit serb të Kosovës. Për më tepër, ndryshe nga të gjitha rajonet e Kosovës, FSK-ja gëzon shumë pak besim mes qytetarëve të rajonit në Mitrovicë-Veri. Rezultatet e Barometrit Kosovar të Sigurisë tregojnë se 52.4 për qind e të anketuarve nga ky rajon deklaruan se nuk kanë aspak besim tek FSK-ja.⁴⁴ Nisur nga mungesa e besimit të qytetarëve në veri dhe marrëveshja që nuk i mundëson aktivitetet e saj në këtë rajon, FSK-ja nuk ka shumë hapësirë në kapacitetet e veta për integrimin e qytetarëve nga ky rajon në FSK, si dhe për integrimin e

42 Shehu, B. (2020). *Albin Kurti publikon një marrëveshje "sekrete" të Thaçit me NATO-on*. DW. Gjendet në: <https://www.dw.com/sq/albin-kurti-publikon-nj%C3%AB-marr%C3%ABveshje-sekrete-t%C3%AB-tha%C3%A7it-me-nato-on/a-52545036>

43 Kallxo.com. (2020). *Marrëveshja e Thaçit me NATO-n u bë fshehtas Komandantes Supreme*. Gjendet në: <https://kallxo.com/shkurt/marreveshja-e-thacit-me-nato-n-u-be-fshehtas-komandantes-supreme/>

44 Marku, D. (2019). *Barometrit Kosovar të Sigurisë - Edicioni i 9-të*. QKSS. Gjendet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2019_339996.pdf

vetë FSK-së në atë rajon. Prandaj, në koordinim me institucionet e tjera, FSK-ja duhet të konsiderojë seriozisht mënyrat si ta menaxhojë këtë situatë në të ardhmen, në mënyrë që multi-etniciteti të pasqyrohet edhe në këtë fushë, si dhe të parandalojë një integrim të nxituar dhe të paqëndrueshëm që rrjedh nga marrëveshjet politike, si në rastin e Policisë së Kosovës. Për të trajtuar sfidat e gjithëpërfshirjes në FSK, përveç përpjekjeve për të pasur një bashkëpunim efektiv ndërinstitutional, është e rëndësishme që të gjitha komunitetet në Kosovë të përqafojnë rëndësinë e shumëllojshmërisë dhe gjithëpërfshirjes në sektorin e mbrojtjes. Për më tepër, duke qenë një institucion kryesor i sigurisë, FSK-ja duhet të trajtohet nga të gjitha komunitetet si platformë për adresimin e nevojave dhe sfidave të tyre, ndërkohë që mungesa totale e kontaktit të qytetarëve nga rajoni i Mitrovicë-Veri me këtë institucion nuk e lejon këtë. Qeverisë së Kosovës, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, i duhet punë e gjerë për rritjen graduale të prezencës së FSK-së në rajonin e Mitrovicë-Veri. Kjo mund të arrihet duke siguruar pjesëmarrjen e FSK-së në aktivitete të ndryshme që nuk kanë karakter ushtarak në rajonin e Mitrovicë-Veri, siç janë ligjëratat në shkolla, fushatat humanitare, ndihma për zhvillimin e infrastrukturës etj. Aktivitete të tilla mund të organizohen së bashku me KFOR-in, gjegjësisht në këtë mënyrë do të konfirmohej bashkëpunimi i ngushtë i FSK-së me NATO-n dhe do të ofrohej një garanci shtesë për karakterin mbrojtës dhe gjithëpërfshirës të FSK-së.

ZVOGËLIMI I HENDEKUT GJINOR

Përfaqësimi i dobët gjinor, veçanërisht në komunitetet jo-shumicë është një sfidë tjetër që shtrihet në nivelin vendor, duke iu referuar rrjedhimisht edhe FSK-së. Nga numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të FSK-së nga komunitetet jo-shumicë, vetëm 23 prej tyre janë gra.⁴⁵ Ndërsa, gjithsejtë janë 222 gra të angazhuara në FSK në grada të ndryshme, ku njëra prej tyre mban gradën më të lartë ushtarake në FSK, Gjeneral Brigade.⁴⁶ Bazuar në politikën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në MM dhe FSK, sfidat e brendshme të përfaqësimit të grave janë përfaqësimi i ulët i grave, veçanërisht në pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse.⁴⁷ Nga ana tjetër, mentaliteti i përgjithshëm në Kosovë ndikon edhe në përfaqësimin e grave në FSK duke rezultuar me pranimin e ngadaltë nga publiku i gjerë të konceptit të grave si pjesëtarë aktive

45 Raporti Vjetor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, 2019.

46 Politika e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK.

47 Po aty.

në shërbim.⁴⁸ FSK-ja synon t'i adresojë sfidat në lidhje me këtë duke siguruar trajtim preferencial, rekrutim, punësim dhe ngritje në detyrë në kuadër të FSK-së, aty ku ka përfaqësim të pabarabartë, si dhe duke ndërmarrë masa të posaçme të përkohshme për të arritur barazinë gjinore, aty ku ekziston pabarazia, siç kërkohet nga ligjet në fuqi.⁴⁹ FSK-ja duhet t'i trajtojë, mbështesë dhe promovojë në mënyrë të vazhdueshme individët në kuadër të institucionit që janë përgjegjës për çështjet gjinore, si dhe duhet ta përcaktojë punën e tyre specifike për të gjitha fushat e organizatës së vet. Për më tepër, ajo duhet të jetë e fokusuar në përfaqësimin e grave në trajnime dhe arsim, në mënyrë që të inkurajohen gratë të marrin pjesë më shumë në trajnime profesionale, duke rritur kështu shanset e përfaqësimit në të gjitha gradat.

48 Aliu, L. (2018). *Gruaja që formëson ushtaret e ardhshme të Kosovës*. Kosovo 2.0. Gjetet në: <https://kosovotwopointzero.com/en/the-woman-shaping-kosovos-future-soldiers/>

49 Politika e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK.

KORNIZA LIGJORE E PK-SË PËR GJITHËPËRFSHIRJEN ETNIKE

Gjithëpërfshirja etnike në kuadër të PK-së rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-76 për Policinë, si dokumenti bazik ligjor për PK-në. Në kuadër të ligjit janë paraparë dispozita specifike që adresojnë karakterin shumetnik të PK-së. Në këtë drejtim, një nga parimet udhëheqëse të PK-së është përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Kosovë.⁵⁰

Për sa i përket përfaqësimit etnik në PK, Ligji për Policinë përcakton se përbërja etnike e zyrtarëve policorë në kuadër të një komune pasqyron përbërjen etnike të popullatës në kuadër të asaj komune.⁵¹ Kur flitet për përfshirjen në PK të komuniteteve jo-shumicë, posaçërisht të komunitetit serb të Kosovës, ligji ka adoptuar një qasje fleksibile në drejtim të integritetit. Prandaj, me ligj përcaktohet që në komunat ku komuniteti serb i Kosovës është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve emërohen nga Ministria e Punëve të Brendshme me propozimin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së.⁵²

50 Paragrafi 1.7, Neni 2, Ligji Nr. 04/L-76 për Policinë. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>.

51 Paragrafi 4, Neni 35, Ligji Nr. 04/L-76 për Policinë. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>.

52 Neni 42, Ligji Nr. 04/L-76 për Policinë. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>.

GJENDJA AKTUALE E GJITHËPËRFSHIRJES ETNIKE NË POLICINË E KOSOVËS

Integrimi i komuniteteve jo-shumicë në kuadër të PK-së është mjaft solid në aspektin e përfaqësimit në kuadër të këtij institucioni. Vlen të përmendet se nga personeli i përgjithshëm prej 8,861 punonjësish në PK, 1,406 prej tyre përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë të Kosovës. Kjo nënkupton se gjithëpërfshirja është një ndër parimet kyçe të institucioneve e Kosovës për krijimin e një force policore shumetnike që pasqyron shumëllojshmërinë etnike të shoqërisë në përgjithësi. Statistikat e detajuara për përfaqësimin etnik në kuadër të PK-së paraqiten në figurën e mëposhtme.

Kur shifrat e përgjithshme interpretohen sipas përqindjeve, del se rreth 16 përqind e stafit civil dhe zyrtarëve policorë të PK-së përbëhet nga komunitetet jo-shumicë. Në këtë drejtim, komuniteti serb në Kosovë përfaqësohet me 12 përqind gjithsejtë në kuadër të PK-së dhe rrjedhimisht mund të thuhet se komuniteti serb në Kosovës është i përfaqësuar mirë në institucionet e sigurisë, me theks të veçantë në PK. Ndërsa, 4 përqindjet e tjera ndahen mes komuniteteve të tjera jo-shumicë (komunitetet e boshnjakëve, turqve, goranëve, ashkalinjve, romëve, egjiptasve, çerkezëve, malazezëve, kroatëve dhe maqedonasve, siç tregohet nga statistikat e siguruar nga PK-ja). Ndërkohë, shqiptarët e Kosovës, si popullsia shumicë e vendit, përbëjnë 84 përqind të personelit në PK.

Tabela 2 - Numri i përgjithshëm i personelit (civil dhe të uniformuar) të Policisë së Kosovës – sipas përkatësisë etnike⁵³

Përkatësia etnike	Numri	Përqindja
Shqiptar	7455	84.13%
Serb	1037	11.70%
Boshnjak	203	2.29%
Turk	72	0.81%
Goran	39	0.44%
Ashkali	19	0.21%
Rom	15	0.17%
Egjiptas	8	0.09%
Çerkez	6	0.07%
Malazez	3	0.03%
Kroat	3	0.03%
Maqedonas	1	0.01%
Gjithsej	8861	100.00%

Sa i përket personelit civil dhe zyrtarëve policorë, PK-ja ka 1,011 anëtarë të stafit civil dhe 7,850 zyrtarë policorë të shpërndarë në grada dhe pozita të ndryshme në kuadër të PK-së. Prej tyre, 109 anëtarë të stafit civil janë nga komunitetet jo-shumicë dhe 1,297 të tjerë janë zyrtarë policorë (personel në uniformë) që përfaqësojnë komunitete të ndryshme jo-shumicë. Kështu, 8 për qind e stafit civil përfaqëson komunitetin serb të Kosovës, ndërkohë që zyrtarët policorë që i përkasin komunitetit serb të Kosovës janë 12 për qind, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

53 Të dhënat statistikore i janë dhënë Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë nga Policia e Kosovës më 2 mars 2020.

Tabela 3 – Personeli civil dhe i uniformuar i PK-së sipas numrave dhe përqindjes (sipas përkatësisë etnike)

Përkatësia etnike	Numri		Përqindja	
	Personeli civil	Zyrtarë policorë	Personeli civil	Zyrtarë policorë
Shqiptar	902	6553	89.22%	83.48%
Serb	83	954	8.21%	12.15%
Boshnjak	13	190	1.29%	2.42%
Turk	7	65	0.69%	0.83%
Goran	3	36	0.30%	0.46%
Ashkali	1	18	0.10%	0.23%
Rom	1	14	0.10%	0.18%
Egjiptas		8		0.10%
Çerkez		6		0.08%
Malazez		3		0.04%
Kroat	1	2	0.10%	0.03%
Maqedonas		1		0.01%
Gjithsej	1011	7850	100.00%	100.00%

Sa u përket gradave që mbajnë në PK pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë, duket se ata janë të përfaqësuar mirë në kuadër të sistemit të gradimit të policisë. Prandaj, në kuadër të personelit të zyrtarëve policorë, serbët e Kosovës janë të përfaqësuar me 2 kolonellë, 4 nënkolonellë, 7 majorë, 14 kapitenë, 26 policë të rinj, 28 togerë, 52 rreshterë, ndërkohë që 821, ose shumica prej tyre, mbajnë gradën e policit dhe shërbejnë në drejtori të ndryshme rajonale të PK-së. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se komuniteti serb në Kosovë është pjesë e strukturës menaxhuese të policisë duke pasur parasysh se Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i PK-së për Burime është pjesëtar i këtij komuniteti jo-shumicë.⁵⁴ Andaj, komuniteti serb i Kosovës është i integruar dhe i përfaqësuar në një mënyrë në të gjitha strukturat e PK-së.

54 Shihni vegëzën në vijim për Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës: <https://www.kosovopolice.com/en/about-us/deputy-general-director-of-kp/>




Figura 1 - Shpërndarja e gradave policore të komunitetit serb të Kosovës në PK⁵⁵

Statistikat e ofruara nga PK-ja dëshmojnë se numri më i lartë i zyrtarëve policorë nga komuniteti serb në Kosovë janë të përfaqësuar në komunat veriore të Kosovës, më saktësisht në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicë-Veri. Për rrjedhojë, 466 zyrtarë policorë në këtë drejtori rajonale janë serbë të Kosovës, pasuar nga Gjilani, Prishtina dhe Ferizaj.

55 Të dhënat statistikore i janë dhënë Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë nga Policia e Kosovës më 2 mars 2020.




Figura 2 - Përfaqësimi i zyrtarëve policorë të komunitetit serb në Kosovë në Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës⁵⁶

Sa i përket përfaqësimit gjinor të komunitetit serb të Kosovës në PK, në këtë institucion janë të punësuar 148 femra dhe 889 meshkuj. Këto shifra për të dy gjinitë përfshijnë si stafin civil ashtu edhe zyrtarët policorë të uniformuar.

⁵⁶ Të dhënat statistikore i janë dhënë Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë nga Policia e Kosovës më 2 mars 2020.



Figura 3 - Përfaqësimi gjinor i komunitetit serb të Kosovës në Policinë e Kosovës (stafi civil dhe zyrtarë policorë)⁵⁷

57 Të dhënat statistikore i janë dhënë Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë nga Policia e Kosovës më 2 mars 2020.

SFIDAT E INTEGRITETIT DHE QEVERISJES SË MIRË TEK ZYRTARËT POLICORË SERBË TË KOSOVËS

Përkundër nivelit të integritit të komunitetit serb të Kosovës dhe përfaqësimit kompakt në kuadër të PK-së, ka disa sfida kur bëhet fjalë për integritetin e zyrtarëve policorë nga ky komunitet. Në këtë drejtim, rajoni më problematik mbetet veriu i Kosovës, i cili u integrua në PK vetëm në vitin 2013 si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit dhe në këtë mënyrë u krijua një drejtori e re rajonale e policisë në Mitrovicë-Veri për të nxitur integrimin në PK të serbëve të Kosovës në katër komunitat veriore të Kosovës. Para kësaj marrëveshjeje, kishte pasur struktura funksionale paralele në fushën e sigurisë të financuara nga Serbia, ndërkohë që shumë ish-anëtarë të Ministrisë së Brendshme të Serbisë (i njohur si MUP) janë rekrutuar në kuadër të PK-së, domethënë në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicë-Veri.⁵⁸

Sipas Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, Kosova dhe Serbia u dakorduan për shkrirjen e strukturave paralele serbe dhe integrimin e pjesëtarëve të tyre në institucionet e Kosovës.⁵⁹ Prandaj, marrëveshja pohon se ekziston “një forcë policore në Kosovë e quajtur Policia e Kosovës” dhe se policia në veriun e Kosovës do të integrohet në kornizën e Policisë së Kosovës.⁶⁰ Në lidhje me procesin e rekrutimit të zyrtarëve policorë serbë të Kosovës në veriun e Kosovës, 285 anëtarë të strukturave paralele u integruan në PK (drejtoria rajonale e policisë në Mitrovicë-Veri). Sidoqoftë, ka pasur kritika se procedurat e integritit ose të rekrutimit nuk janë zbatuar plotësisht kur në PK u inkuadruan ish-anëtarët e strukturave paralele në veriun e Kosovës. Për më tepër, ata kaluan një trajnim njëjavor në vend të trajnimit të rregullt

58 Balaj, S. (2019). *Perceptimi i komunitetit serb të Kosovës kundrejt Policisë së Kosovës: Mike apo armike?* Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 7. Gjetend në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community_KosovoPolice-alb_\(1\)_605460.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community_KosovoPolice-alb_(1)_605460.pdf).

59 Po aty, f. 11.

60 Marrëveshja e Brukselit për parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve gjendet këtu: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/FIRST_AGREEMENT_OF_PRINCIPLES_GOVERNING_THE_NORMALIZATION_OF_RELATIONS,_APRIL_19,_2013_BRUSSELS_en.pdf.

9-mujor në PK, që është një procedurë e standardizuar për punësimin e zyrtarëve policorë.⁶¹ Ndërkohë, nuk ka informata për profilin dhe sfondin e tyre gjatë shërbimit si anëtare të MUP-it, duke marrë parasysh që ata kaluan nëpër një proces të lehtësuar dhe të përshpejtuar të verifikimit të sigurisë për t'ju bashkëngjitur PK-së.⁶²

Nga ana tjetër, Inspektorati Policor i Kosovës është i pranishëm në veriun e Kosovës, por dëshmitë tregojnë se drejtoria rajonale e policisë në Mitrovicë-Veri është sfiduar ashpër kur flitet për integritetin e policëve të saj dhe qeverisjen e mirë në përgjithësi. Ka disa raste që tregojnë për ekzistencën e akuzave serioze se zyrtarët policorë në veriun e Kosovës dyshohen se kanë qenë të përfshirë në veprimtari të paligjshme, të cilat do të prezantohen shkurtimisht këtu.

RASTI I STACIONIT POLICOR TË ZUBIN POTOKUT

Në shkurt të vitit 2020, PK-ja publikoi një informacion publik se gjatë një inspektimi të kryer në drejtorinë rajonale të policisë në Mitrovicë-Veri, u konstatuan disa sjellje të pahijshme në stacionin policor në Zubin Potok.⁶³ Sipas raportimeve të mediave, nga dhoma e provave në stacionin policor në Zubin Potok janë vjedhur disa pajisje policore, përfshirë armë zjarri,⁶⁴ prandaj tre zyrtarë të këtij stacioni policor janë pezulluar tashmë - një zyrtar i lartë policor i ngarkuar me dhomën e provave, udhëheqësi i hetimeve dhe komandanti i stacionit policor përkatës.⁶⁵ Për më tepër, PK-ja ka konfirmuar se pas hetimeve paraprake, një zyrtar policor nga komuniteti serb në Kosovë dyshohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare sepse nga dhoma e

61 Balaj, S. (2019). *Perceptimi i komunitetit serb të Kosovës kundrejt Policisë së Kosovës: Mike apo armike?* Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 12. Gjetet në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community_KosovoPolice-alb_\(1\)_605460.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Serb-Community_KosovoPolice-alb_(1)_605460.pdf).

62 Bjeloš, M., & Elek, B. (2014). *Integrimi i Policisë në Kosovën Veriore: Progresi dhe sfidat e mbetura në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit*. Beograd dhe Prishtinë: Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, f. 9. Gjetet në: http://www.qkss.org/repository/docs/Integrimi_i_Policise_ne_Kosov%C3%ABn_Veriore_54109.pdf.

63 Shihni njoftimin për shtyp të Policisë së Kosovës në vegëzën në vijim: <https://www.kosovopolicia.com/policia-e-kosoves-ne-zbatim-te-planit-vjetor-te-punes/>.

64 Donika Voca Gashi, "Në Stacionin Policor të Zubin Potokut u morën armë në dhomën e dëshmive - tre të suspenduar", Koha.Net, 4 mars 2020. Gjetet në: <https://www.koha.net/arberi/211761/ne-stacionin-policor-te-zubin-potokut-u-moren-arme-ne-dhomen-e-deshmive-tre-te-suspenduar/>.

65 Shihni njoftimin për shtyp të Policisë së Kosovës në vegëzën në vijim: <https://www.kosovopolicia.com/policia-e-kosoves-ne-zbatim-te-planit-vjetor-te-punes/>.

provave e stacionit policor në Zubin Potok janë vjedhur lloje të ndryshme të armëve të zjarrit.⁶⁶

Ky rast është aktualisht nën hetim nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë.⁶⁷ Meqenëse rezultatet e hetimeve nuk dihen dhe ato nuk kanë përfunduar ende, mund të supozohet se integriteti i zyrtarëve policorë në kuadër të drejtorisë rajonale të PK-së në Mitrovicë të Veriut është vënë në dyshim për shkak të kësaj sjelljeje të pahijshme. Kjo mund t'i atribuohet edhe procedurave të përshpejtuara të rekrutimit të zyrtarëve policorë në komunat veriore të Kosovës, siç u përmend më herët.

AKSIONI POLICOR NË VERI

PK-ja ka ndërmarrë disa veprime policore në veriun e Kosovës me qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit në këtë rajon. Në maj të vitit 2019, një aksion policor në veri, i udhëhequr bashkërisht nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe njësitë speciale të PK-së, rezultoi në arrestimin e një numri zyrtarësh policorë⁶⁸ mes personave të tjerë të arrestuar. Ata u arrestuan nën dyshimin e bazuar se ishin përfshirë në kontrabandë mallrash, keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe aktivitete rryshfeti.⁶⁹ Është e rëndësishme të theksohet se ky aksion specifik policor në veri u pengua nga pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës që vendosën barriera në rrugë, duke e penguar kështu PK-në në zbatimin e aksionit të vet, posaçërisht në Zubin Potok⁷⁰. Sidoqoftë, barrierat u hoqën nga njësitë speciale të PK-së, ndërkohë që iu hap rruga përmbushjes së detyrave policore për zbatimin e veprimeve policore.

66 Telegrafi, "Zubin Potok, zyrtari policor vjedh armë nga dhoma e dëshmive", 3 mars 2020. Gjendet në: <https://telegrafi.com/zubin-potok-zyrtari-policor-vjedh-arme-nga-dhoma-e-deshmive/>.

67 Donika Voca Gashi, "Në Stacionin Policor të Zubin Potokut u morën armë në dhomën e dëshmive - tre të suspenduar", Koha.Net, 4 mars 2020. Gjendet në: <https://www.koha.net/arberi/211761/ne-stacionin-policor-te-zubin-potokut-u-moren-arme-ne-dhomen-e-deshmive-tre-te-suspenduar/>.

68 Afërdita Fejzullahu, "Arrestime, plagosje e barrikada nga aksioni i sotëm i Policisë së Kosovës", 28 maj 2019. Gjendet në: <https://kallxo.com/shkurt/arrestime-plagosje-e-barrikada-nga-aksioni-i-sotem-i-policise-se-kosoves/>.

69 Telegrafi, "Policia konfirmon aksionin në veri të Mitrovicës, jep detaje", 28 maj 2019. Gjendet në: <https://telegrafi.com/policia-konfirmon-aksionin-ne-veri-te-mitrovices-jep-detaje/>.

70 Afërdita Fejzullahu, "Arrestime, plagosje e barrikada nga aksioni i sotëm i Policisë së Kosovës", 28 maj 2019. Gjendet në: <https://kallxo.com/shkurt/arrestime-plagosje-e-barrikada-nga-aksioni-i-sotem-i-policise-se-kosoves/>.

KRITIKA NDAJ PERFORMANCËS SË DREJTORISË RAJONALE TË POLICISË NË MITROVICË-VERI

Përkundër këtyre sfidave, menaxhmenti i lartë i Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së me seli në Prishtinë ka ngritur shqetësime serioze për aktivitetet e brendshme dhe performancën e drejtorisë rajonale të policisë në Mitrovicë të Veriut, në lidhje me luftimin e krimeve në verin e Kosovës që janë nën përgjegjësinë e kësaj drejtorie të policisë. Në një letër drejtuar drejtorisë rajonale të policisë në Mitrovicë-Veri, në prill të vitit 2018, menaxhmenti i PK-së shpreh kritika që pavarësisht nga incidentet në rritje në veri të Kosovës (incidente zjarri, zjarrëvënie dhe shpërthime të granatave), këto raste nuk janë zbuluar dhe autorët e tyre nuk janë sjellë para drejtësisë. Letra trajton, ndër të tjera, çështjen e besueshmërisë së ulët ndaj PK-së në veri, duke u shprehur se nuk mund të pritet të rritja e besueshmërisë së publikut ndaj policisë kur mungojnë rezultatet e hetimeve për këto raste përkatëse.⁷¹ Bazuar në këtë deklaratë të menaxhmentit të lartë të PK-së, mund të supozohet se një nga arsyt e besueshmërisë shumë të ulët ndaj policisë në veriun e Kosovës është performanca e dobët në luftimin e krimeve nga ana e drejtorisë rajonale të policisë në Mitrovicë-Veri.

71 Kosova Press, "Ekskluzive: Raporti i krerëve të Policisë ku flitet për veriun (Dokument)", 1 maj 2018. Gjetet në: <http://www.kosovapress.com/sq/siguri/-160317/>.

REKOMANDIME

- Duhet të përmirësohen masat e inteligjencës dhe parandalimit nga Kosova, për t'iu përgjigjur më mirë ndikimeve të jashtme që synojnë të minimizojnë procesin e integritetit të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, konkretisht të komunitetit serb në Kosovë;
- FSK-ja, në bashkëpunim me institucionet e tjera, me theks të veçantë me institucionet e sigurisë, duhet të hartojë një plan afatgjatë për parandalimin e ndërhyrjes së jashtme dhe garantimin e sigurisë shtesë për pjesëtarët e saj të prekur drejtpërdrejt nga një ndërhyrje e tillë;
- FSK-ja, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet e tjera, duhet të punojë për shtrirjen e pranisë së saj në rajonin e Mitrovicë-Veri përmes aktiviteteve jo-ushtarake. Kjo do të kontribuojë në rritjen e besimit të komunitetit serb në Kosovë ndaj FSK-së dhe do ta inkurajojë më tej gjithëpërfshirjen;
- FSK-ja duhet ta inkudrojë gjithëpërfshirjen, veçanërisht në aspektin gjinor, në procesin e arsimimit të kadetëve të rinj në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëri në këtë drejtim. Kjo duhet të bëhet duke futur sistematikisht përmbajtje mbi rëndësinë e gjithëpërfshirjes së komuniteteve jo-shumicë dhe barazisë gjinore;
- FSK-ja duhet të angazhojë më shumë gra dhe komunitete jo-shumicë në trajnime dhe arsimim, në mënyrë që të sigurojë mundësi shtesë për ngritje në detyrë, si dhe të inkurajojë pjesëtarët e tjerë të marrin pjesë në trajnime/arsimime të tilla;
- FSK-ja duhet të vazhdojë të forcojë bashkëpunimin me forcat e armatosura shumë-nike, si ato të Zvicrës, për shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e vazhdueshëm të praktikave të mira në këtë drejtim;
- Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë një rol më pro-aktiv në përmirësimin e dialogut të brendshëm për të adresuar çështjet e gjithëpërfshirjes etnike dhe gjinore. Kjo duhet të përqendrohet në targetimin e komuniteteve etnike që janë më hezituese në veçanti;

- Organizatat e shoqërisë civile duhet të organizojnë më shumë debate dhe diskutime me komunitetet jo-shumicë në lidhje me rolin e FSK-së dhe çështjen e stigmatizimit në komunitet të pjesëtarëve të FSK-së nga komunitetet jo-shumicë;
- Nëse Policia e Kosovës dhe Inspektorati Policor i Kosovës kanë bërë deri më tash, atëherë duhet të ndërmarrin inspektime të rregullta/të jashtëzakonshme më të shpeshta ndaj drejtorisë rajonale të policisë në Mitrovicë-Veri. Kjo duhet të bëhet për rritjen e integritetit profesional dhe qeverisjes së mirë në kuadër të kësaj drejtorie policore, e cila siç duket po përballet me sfida serioze, siç nxjerr në pah rasti në Zubin Potok;
- Meqenëse përfaqësimi etnik dhe gjinor nuk janë komponentë të mjaftueshëm për forcimin e integritetit, institucionet përkatëse të Kosovës duhet të rishqyrtojnë ofrimin e një serie programesh trajnimi për zyrtarët policorë në drejtorinë rajonale të policisë në Mitrovicë të Veriut. Këto programe trajnimi duhet të përqendrohen në matjet e integritetit në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe çështjeve të lidhura me krimin e organizuar;
- Mekanizmi i kontrollit të brendshëm ose organet e tjera përkatëse të Policisë së Kosovës duhet të bëjnë vlerësimin e performancës në çdo periudhë tre mujore për të gjitha drejtoritë rajonale të policisë, përfshirë rajonin e Mitrovicë-Veri. Metodologjia e përdorur për vlerësimin e performancës duhet të ketë indikatorë/nën-indikatorë specifikë për matjen e progresit bazuar në aktivitetet e realizuara nga drejtoritë rajonale të policisë në fushën e sundimit të ligjit, duke ndikuar kështu në përmirësimin e qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional të Policisë së Kosovës dhe zyrtarëve policorë në të gjitha nivelet ose gradat.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351(496.51)(047)

Balaj, Shpat

Sfidat dhe praktikat e gjithëpërfshirjes në sektorin e sigurisë në Kosovë / Shpat
Balaj, Plator Avdiu. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2020. -
36 f. ; 21 cm.

1.Plator Avdiu

ISBN 978-9951-799-06-5

www.qkss.org

ISBN 978-9951-799-06-5



9 789951 799065